

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, Divizioni penal, me gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behiije Karaçica, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V. K. nga fshati P., komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP.nr.133/2017 të datës 28.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, 24.07.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Armend Zenelaj, si dhe të akuzuarit V. K., të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: V. K., nga i ati R. dhe e ëma M., e lindur K., i lindur me datën ... në fshatin P., komuna e Malishevës, ku edhe tani jeton, me nr.lnj...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punëtor fizik, i martuar, i ati i një (1) fëmije, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 26.01.2017, rreth orës 12:00, në fshatin P., komuna e Malishevës, në drejtim të qytetit të Malishevës, i pandehuri duke drejtuar automjetin e tij të tipit "Opel Astra", ngjyrë e kaltër, me targa të regjistrimit ..., ka rrezikuar trafikun publik, pasurin në masa të mëdha dhe jetën e të dëmtuarve B. K., F. F., Z. K. dhe F. K., ashtu që ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 53, 59 dhe 65 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vie deri te pasoja e ndaluar, lehtas e ka marrë se gjerë te ajo nuk do të vie apo në momentin e duhur do ti shmanget, në atë mënyrë që me të arritur në dalje të fshatit P., duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë meqenëse ishte rrugë me kthesa e mbuluar me borë dhe akull si dhe duke mos mbajtur anën e djathtë të rrugës gjatë përball kalimit, humb kontrollin ndaj automjetit duke kaluar nga shiriti i djathtë i rrugës në atë të majtë ku me pjesën ballore të anës së majtë të automjetit e godet në pjesën e parë të anës së majtë automjetin e tipit "Vw Jetta", ngjyrë e kaltër, me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte i dëmtuari F. K., i cili ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt, me ç'rast shkaktohen dëme materiale si dhe dëmtime të rënda trupore pëson e dëmtuara Z. K., ndërsa të dëmtuarve B. K., F. F. dhe F. K., pësojnë dëmtime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.D. H. e dt.13.04.2017.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i a shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të dëmtuarit F. F. nga F., Rr."G.B. S.", F. K., B. K. dhe Z. K., që të tre nga fshati P.ë, komuna e Malishevës, lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia paguaj shumën prej 90 euro, si dhe në emër të shpenzimeve paushallë të paguaj shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.133/2017 të datës 28.08.2017, e ka akuzuar V.K. nga fshati P., komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të gjitha provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 24.07.2018, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Armend Zenelaj, i akuzuari V. K., andaj ka pasur kushte për vazhdimin e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari V. K., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se i vjen keq për rastin i cili ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë, për të cilin është penduar, po ashtu ka deklaruar se automjetin e ka pasur të siguruar, ky ka qenë rasti i tij i parë që ka ra ndesh me ligjin, andaj i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që mos të bije ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, jep mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPPK-së, ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimi të fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi që është kryerës i kësaj vepre penale që akuzohet sipas aktakuzës, andaj në tërësi ka pranuar fajësinë, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur në provat të cilat i janë ofruar gjykatës si: ekspertiza e ekspertit mjekoligjore e Dr.D. H. e dt.23.03.2017, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ingj.B. P. e dt.09.03.2017, foto-dokumentacioni, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Pasi që i akuzuari e pranoj fajësinë gjykata nuk u lëshua në procedurën e provave e kjo në pajtim me nenin 326 të KPPK-së, pasi që gjykata vlerësoj se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat ligjore dhe se gjykata ishte e bindur se i akuzuari i ka kuptuar të gjitha pasojat eventuale mbi pranimin e fajësisë, për çka edhe gjykata e pranoj me aktvendim pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Pas vlerësimit të të gjitha provave si dhe pas deklarimit të përfaqësuesit të akuzës si dhe vet të akuzuarit gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, për çka gjykata i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë matjes së dënimit gjykata kishte parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë faktin se i akuzuari kishte sjellje të sinqerta gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, është i ati i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, si dhe nuk është përsëritës i veprave penale, ndërsa nuk ka gjetur rrethana rënduese, mu për këtë i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me një dënim të këtillë do të arrihet efekti pozitiv i qëllimit të dënimit, në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ashtu që i akuzuari në të ardhmen të mos kryen vepra të ngjashme penale si dhe çfarë do lloj tjetër të veprave penale.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin e rregullt civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMEMLORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË

P.nr.277/2017, me datën 24.07.2018

**Sekretarja juridike
Behije Karaçica**

**G j y q t a r i
Lulzim Paçarizi**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

